

**DOKUMENTI I RISHIKUAR I
PROGRAMIT BUXHETOR
AFATMESËM
2018-2020**

SHTATOR/2017

PËRGATITI : GRUPI PËR MENAXHIMIN STRATEGJIK

PËRMBAJTJA

Dokumenti i rishikuar i Programit Buxhetor Afatmesëm 2018-2020

1. Hyrje
 - Roli i Programit Buxhetor Afatmesëm
 - Qëllimet kryesore të Programit Buxhetor Afatmesëm
2. Objektivat e PBA
3. Kush përfshihet në PBA
4. Çfarë parashikojmë në këtë PBA
 - Prioritetet e PBA 2018-2020
5. Parashikimi i të ardhurave tatimore për periudhën afatmesme 2018-2020
6. Parashikimi buxhetor afatmesëm
7. Programe e PBA 2018-2020
 - 7.1 Programi i Administratës Publike (Planifikim, Menaxhim, Administrim)
 - 7.2 Programi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Emergjencat Civile
 - 7.3 Programi i Administrimit të Pyjeve
 - 7.4 Programi i Menaxhimit Rrugor dhe Transporti Publik
 - 7.5 Programi i Pastrimit, Gjelbërimit Ndriçimit
 - 7.6 Programi i Arsimit
 - 7.7 Programi i Zhvillimit të Sportit
 - 7.8 Programi i Kulturës
 - 7.9 Programi i Kujdesit Social
 - 7.10 Programi i Ujitjes dhe Kullimit
8. Transferta e kushtëzuar
9. Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
10. Konkluzione

Informacion i përgjithshëm mbi Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2018 - 2020

1. Hyrje

1 Roli i Programit Buxhetor Afatmesëm

Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA) është një instrument operacional për menaxhimin e shpenzimeve publike dhe një komponent kyç i Sistemit të Planifikimit të Integruar. Ai është rezultat i dy proceseve: Rishikimit të Politikave dhe Planifikimit të Shpenzimeve dhe Investimeve të Programit.

2. Qëllimet kryesore të PBA janë:

- Qëllimi i Programit Buxhetor Afatmesëm vendor është të bëjë të zbatueshëm Planin Strategjik të Zhvillimit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet planifikimit dhe menaxhimit të financave vendore dhe shërbimeve për një periudhë tre vjeçare.
- Inkurajimi i efektivitetit, efikasitetit dhe ekonomisë në kryerjen e shpenzimeve publike;
- Lidhje e drejtpërdrejtë ndërmjet prioriteteve strategjiko-politike të Qeverisë me shpërndarjen e burimeve publike dhe kryerjen e shpenzimeve publike;
- Promovimi i disiplinës fiskale duke mundësuar që shpenzimet publike të planifikohen brenda një kuadri realist makroekonomik dhe fiskal;
- Zgjerimi i vizionit të procesit buxhetor duke siguruar që programet e shpenzimeve të planifikohen në një periudhë afatmesme (3- vjeçare).

Duhet theksuar gjithashtu që procesi i hartimit të PBA është i orientuar mbi bazën e performancës. Çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme (ku përfshihen edhe njësitë e qeverisjes vendore) përgatit kërkesat buxhetore në kuadër të PBA, me qëllim që të sigurojë që shpërndarjet e fondeve buxhetore të reflektojnë qëllimet e politikës gjatë një periudhe afatmesme (3-vjeçare) duke bërë një lidhje të drejtpërdrejtë ndërmjet shpërndarjes së buxhetit dhe objektivave të politikës së programit. Është e rëndësishme të kihet parasysh që përgatitja e buxhetit vjetor është pjesë përbërëse e procesit të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm si dhe, që buxheti vjetor do të jetë viti i parë i këtij programi.

Kërkesat buxhetore të çdo njësie të qeverisjes së përgjithshme përmbajnë:

- a) misionin e njësisë
- b) përshkrimin e programeve dhe veprimtarive të kësaj njësie;
- c) paraqitjen e qëllimit dhe objektivave të politikës së programeve të shoqëruar me treguesit përkatës të performancës;
- d) planifikimin e shpenzimeve për çdo program sipas produkteve dhe aktiviteteve.
- e) treguesit faktikë për vitin buxhetor paraardhës, treguesit buxhetorë të planifikuar për vitin buxhetor në vazhdim, si edhe për tri vitet e ardhshme buxhetore;
- f) shpenzimet kapitale, listën e projekteve të investimeve për çdo program me:
 1. koston e plotë të projektit;
 2. vlerën e financuar deri në fund të vitit buxhetor paraardhës;
 3. vlerën e parashikuar për tu financuar në vitin buxhetor;
 4. vlerën e mbetur për tu financuar në vitet pasardhëse buxhetore, burimet e financimit;
- g) projektin e planit të arkës vjetor dhe të ndarë në muaj, si pjesë e projektbuxhetit vjetor dhe përfshin:
 1. Fluksin e të ardhurave të parashikuara për tu mbledhur dhe arkëtime të tjera;
 2. Planin e prokurimeve dhe angazhime të tjera të planifikuara;
 3. Pagesat e parashikuara që rrjedhin nga angazhimet.
- h) planin financiar vjetor të njësisë publike të krijuara dhe të kontrolluara nga njësia e qeverisjes së përgjithshme.

Përgatitja e kërkesave buxhetore për njësitë e vetëqeverisjes vendore realizohet nëpërmjet formateve të përcaktuara nga Ministri i Financave, të cilat janë pjesë e udhëzimeve vjetore të

Dokumenti i rishikuar i Programit Buxhetor Afatmesëm 2018-2020

përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm për njësitë e vetëqeverisjes vendore.

2. Objektivat e Programit Buxhetor Afatmesëm

-Përmirësimi i menaxhimit të shpenzimeve publike dhe rritja e efikasitetit të përdorimit të fondeve buxhetore, në funksion të të cilit, angazhimi dhe mbështetja serioze e me përgjegjësi të lartë e të gjitha njësive pjesmarrëse të PBA, mbetet thelbësore për ecurinë e suksesshme të këtij procesi.

-Sigurimi i një shpërndarjeje dhe përdorimi efektiv dhe eficient i burimeve .

3. Kush përfshihet në Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA)

Ky dokument u përgatit nga:

Grupi për Menaxhim Strategjik

Administrata e Bashkisë

Institucionet e varësisë

Njësitë Administrative

4. Cfarë parashikojmë në këtë Program Buxhetor Afatmesëm :

✓ Prioritetet e PBA-së 2018-2020

Shtyllat kryesore në të cilat është mbështetur hartimi i buxhetit afatmesëm janë:

- Zhvillimi ekonomik i qytetit dhe nxitja e punësimit
- Ofrimi i shërbimeve cilësore
- Përmirësimi i infrastrukturës dhe transportit
- Rigjallërimi i jetës kulturore dhe sportive
- Ndërtime dhe rikonstruksione të veprave publike
- Cilësi dhe garantimi i pastërtisë dhe shërbimeve të tjera publike

5. Parashikimi i të ardhurave tatimore për periudhën afatmesme

Parashikimi i të ardhurave tatimore për periudhën afatmesme për vitet 2018-2020 për Bashkinë e Korçës është mbështetur në llogaritjet e kapacitetiteve për taksat dhe tarifatat, në bazën e të dhënave dhe ekstrakti i informacionit të gjeneruar nga programi i taksave vendore, në ecurinë e realizimit të taksave dhe tarifave ndër vite, si dhe politikatat e përcaktuara për periudhën në vijim, duke u mbështetur në legjislacionin aktual në fuqi.

Bazuar në ligjin nr.9936 datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar , ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, të Udhëzimit nr. 23, datë 22.11.2016 “Për procedurat standarte të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”, si dhe udhëzimi plotësues nr. 10/2 datë 13.7.2017 “Për përgatitjen e buxhetit vendor”, ndikim në rritjen e të ardhurave për periudhën 2018-2020 do të ketë edhe nga ndryshimi i taksës vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura pasi kjo taksë nga 18 % bëhet 25% . Pra kemi një rritje prej 7% të të ardhurave nga kjo taksë në krahasim me periudhat e mëparshme.

Dhe tarifa e pastrimit do të ketë ndikim në rritjen e të ardhurave për vitet 2018-2020, pasi duke filluar nga viti 2018 e në vazhdim do të vihet në funksionim landfill i Maliqit në të cilin do të depozitohen mbetjet e Bashkisë Korçë. Venia në funksionim e këtij landfill-i do përmirësojë ndjeshëm nivelin e ndotjes në qytet, largimin nga zona e banuar e vend grumbullimit të mbetjeve e cila për një periudhë të gjatë kohore është kthyer në një shqetësim të madh për qytetin. Vendgrumbullimi aktual përbën një rrezik madhor për ndotjen dhe kontaminimin e burimeve ujore nëntokësore të cilat furnizojnë depoziten e ujit të pijshëm të qytetit. Për të eliminuar këto rreziqe me fokus kryesor mbrojtjen e

Dokumenti i rishikuar i Programit Buxhetor Afatmesëm 2018-2020

shëndetit të qytetarëve ne si Bashki lider në këtë projekt kemi tërhequr në bashkëpunim dhe Bashkitë e tjera të qarkut që të mundesonim realizimin e këtij projekti madhor. Rritja e standarteve të menaxhimit të mbetjeve urbane në landfill sanitary kërkon një kosto të integruar e cila i shërben këtij të fundit për mirëfunksionimin e tij në një periudhë 20 vjecare.

Ky planifikim jepet si më poshtë:

në 000/lekë

Nr	Emertimi i të Ardhurave Tatimore	Fakti i vitit 2016	Plan 2017	Parashikimi për vitin 2018	Parashikimi për vitin 2019	Parashikimi për vitin 2020
I.	Të ardhura nga taksa	294,507	501,800	522,903	533,363	544,028
1	Taksa vendore mbi biznesin e vogël	11,870	40,000	40,800	41,616	42,448
2	Taksa mbi Ndërtesat	120,053	137,000	139,740	142,535	145,385
3	Taksë mbi truallin	4,710	7,000	7,140	7,283	7,428
4	Taksa mbi token bujqësore	22,451	36,500	37,230	37,975	38,734
5	Taksa e fjetjes në hotel	3,191	3,900	3,978	4,058	4,139
6	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	64,599	180,000	183,600	187,272	191,017
7	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet	8,219	20,000	20,400	20,808	21,224
8	Taksa e ndikimit nga ministria e energjise	1,804		0	0	0
9	Dividenti nga UKKO	5,345				
10	Renta minerare	63				
11	Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme	4,412	9,000	9,180	9,364	9,551
12	Taksa vjetore e mjeteve te përdorura	23,195	30,000	41,667	42,500	43,350
13	Taksa e regjistrimit të përvitshëm biznesi	1,824	2,000	2,040	2,081	2,122
14	Taksa e tabelës	5,008	19,000	19,380	19,768	20,163
15	Taksa për Reklame	11,162	9,000	9,180	9,364	9,551
16	Taksa për therjen e bagëtive	571	700	714	728	743
17	Taksa të përkohshme për linjat ajrore dhe nëntokësore	1,884	3,200	3,264	3,329	3,396
18	Takse Tavoline	4,146	4,500	4,590	4,682	4,775
II.	Të ardhura nga tarifat	215,299	252,905	299,992	306,024	312,180
1	Tarifa për pastrim	109,958	117,000	161,369	164,630	167,956
2	Tarifa për hapësira publike(servitut+kantina+tregu I lire+mall j.dyqanit)	2,063	2,000	2,040	2,081	2,122
3	Tarife ndriçimi rrugor	36,317	39,955	40,754	41,569	42,401
4	Tarife uji i pijshem	2,561	2,550	2,601	2,653	2,706
5	Tarife varreza	10,598	17,000	17,340	17,687	18,041
6	Tarife gjelbërimi	22,321	26,000	26,520	27,050	27,591
7	Tarifa për zënien e hapësirave publike	7,491	8,000	8,160	8,323	8,490
8	Tarifa parkimi	16,475	21,000	21,420	21,848	22,285
9	Tarife për shërbime te tjera administrative	5,592	16,000	16,320	16,646	16,979
10	Tarife rregjistrimi per leje transporti	1,236	2,000	2,040	2,081	2,122
11	Tarife muri perimetral	400	700	714	728	743
12	Tarife per dhenie e treguesve te zhvillimit	287	700	714	728	743
III.	Të ardhura nga shitja e pronës dhe dhënia me qera	4,202	14,620	14,912	15,211	15,515
1	Qera objekti+qera trualli+qera toka bujqësore+qera kullota	4,202	14,620	14,912	15,211	15,515
IV.	Të ardhura nga ndërmarrjet e ndryshme	4,293	3,775	3,851	3,928	4,006
V.	Të ardhura të tjera	478,409	574,690	559,114	577,372	621,055
1	Transferta e Pakushtëzuar	324,808	395,385	415,154	437,573	482,643
2	Tarife për shërbime sociale (arsim parashkollor konvikte)	10,735	11,050	11,271	11,496	11,726

Dokumenti i rishikuar i Programit Buxhetor Afatmesëm 2018-2020

3	Sporte dhe kultura	1,205	1,263	1,288	1,314	1,340
4	Dhurata dhe sponsorizime te ndryshme	704	0	0	0	0
5	Te ardhura nga gjobat	8,945	9,500	9,690	9,884	10,081
6	Çertifikatë për mbrojtjen nga zjarri	584	50	51	52	53
7	Miratim projekti	298	500	510	520	531
8	Shërbime zjarrfikse në objekte të siguruara	0	90	92	94	96
9	Shërbime zjarrfikse në bashki fqinje	0	300	306	312	318
10	Marrje me qera pylli	87	4,800	4,896	4,994	5,094
11	Të ardhura nga shitja e druve të zjarrit+heqje materialit drusor	8,761	3,000	3,060	3,121	3,184
12	Vertetime transporti	0	50	51	52	53
13	Prodhimet e dyta medicinale	0	100	102	104	106
14	Te ardhurat te trasheguara nga viti i kaluar	112,013	136,453	100,251	95,216	92,937
15	Te tjera(enti+banesa soc.+kamata)	10,269	12,149	12,392	12,640	12,893
VI	Totali i te ardhurav te veta (I+II+III+IV+V)	996,710	1,347,790	1,400,772	1,435,898	1,496,784
VII	Te ardhura te kushtezuara	2,485,178	2,937,390	1,488,545	1,488,545	1,488,545
1	Transferta te kushtezuara	654,482	700,000	700,500	700,500	700,500
2	Fondi i Zhvillimit te Rajoneve	1,562,825	1,949,345	500,000	500,000	500,000
3	Transferta specifike	267,871	288,045	288,045	288,045	288,045
VIII	Te ardhurat gjithsej (VI+VII)	3,481,888	4,285,180	2,889,317	2,924,443	2,985,329

6.Parashikimet buxhetore afatmesme 2018-2020

Në vijim të përmbushjes së objektivit për rritjen e standardeve dhe cilësisë së shërbimeve, nëpërmjet rritjes së efijencës në menaxhimin e shpenzimeve, buxheti është hartuar bazuar në:

- Zhvillimin e sistemit të planifikimit afatmesëm, në bazë të programeve të zhvillimit të qytetit, si një mjet për integrimin sa më mirë në procesin buxhetor,
- Aplikimin e sistemit të buxhetimit me pjesëmarrje, bazuar në konsultimet paraprake me banorët e çdo njësie administrative;
- Forcimin e administratës tatimore dhe rritjen e efijencës për realizimin e të ardhurave në kufijtë e kapacitetit;
- Zhvillimin e burimeve alternative të financimit.

Në terma të përgjithshëm programi financiar për periudhën 2018- 2020 paraqet:

- **Parashikimin e të Ardhurave:** Parashikon rritjen e nivelit të të ardhurave nga taksat e tarifat vendore duke forcuar kapacitetet administruese dhe duke rritur numrin e taksapaguesve;
- **Parashikimin e Shpenzimeve:** Alokimin/shpërndarjen e të ardhurave për vitet në vazhdim për: Shpenzime kapitale sipas programeve të zhvillimit të qytetit, Shpenzime operative dhe të mirëmbajtjes për përmbushjen e funksioneve; Shpenzime personeli;
- Buxheti ka në fokus rritjen e cilësisë së shërbimeve në sektorët prioritarë, shërbime publike, arsim dhe infrastrukturë rrugore;
- Zbatimin e politikave kombëtare për përcaktimin e nivelit të pagave;
- Raporti midis shpenzimeve korrente dhe atyre kapitale, arrin respektivisht në 32% me 54%;
- Raporti i burimeve të financimit paraqitet:

23% nga të ardhurat e veta

77% nga të ardhurat nga buxheti i shtetit (transferta e pakushtëzuar, transferta e kushtëzuar, transferta specifike dhe fondi i zhvillimit të rajoneve).

Burimet e financimit të PBA 2018-2020 për Bashkinë Korçë përbëhen nga:

I. Të ardhurat e veta:

- a) Të ardhurat tatimore;
- b) Të ardhurat jotatimore;
- c) Të ardhurat nga njësitë e varësisë;

II. Transferta e pakushtëzuar.

III. Transferta e kushtëzuar;

IV. Transferta specifike

V. Fondi i Zhvillimit të Rajoneve

Parashikimi i shpenzimeve të PBA 2018-2020 për Bashkinë Korçë përbëhen nga:

Mesatarisht për 3-vjeçarin e parashikimit, peshat e shpenzimeve kryesore për vitin 2017 janë:

- Shpenzime personeli 14%
- Shpenzime operative 32%
- Investime 54%

1. Shpenzime për Personelin Në buxhetin e shpenzimeve të personelit për vitin 2017 dhe në vijim, janë reflektuar efektet financiare të ndryshimeve në numrin e punonjësve dhe nivelin e pagave të propozuara. (sipas tabelës nr. 2 bashkangjitur materialit)

2 Shpenzimet Korrente. Shpenzimet korrente përbëhen nga: – Shpenzimet operative për realizimin e funksioneve kryesore, – Shpenzimet për interesat e kredive, – Fondi rezervë dhe fondi i kontigjences – Transferta për buxhete familjare dhe individë (Bonuse, mbështetje sociale, mbështetje të tjera ndaj kategorive të caktuara) – Transferime korrente jashtë . (sipas tabelës nr. 2 bashkangjitur materialit)

3 Shpenzimet kapitale Për vitin 2017 fondi total për shpenzime kapitale është në shumën 2,310,667 mijë lekë ose 54% ndaj totalit të shpenzimeve. (sipas tabelës nr. 2 bashkangjitur materialit)

1. Programi i administratës publike (planifikim, menaxhim, administrim)

Ky program parashikon menaxhimin financiar të Bashkisë Korçë dhe përfshin shpenzimet e nevojshme administrative për mbarrëvajtjen e punës në përmbushjen e funksioneve të përcaktuara në legjislacion.

Politika e Programit

Politika e këtij programi konsiston në përmirësimin e funksionimit dhe menaxhimit të Bashkisë të zhvillimit të kapaciteteve menaxhuese dhe në garantimin e përmirësimit të vazhdueshëm të burimeve njerëzore dhe përdorimit me efektivitet të burimeve financiare të Bashkisë.

Njësitë shpenzuese

Miratimi i strukturës me urdhërin nr. 34 datë 26.1.2017 “Për miratimin e strukturës të administratës së Bashkisë Korçë për vitin 2017” dhe urdhërin nr. 35 datë 26.1.2017 “Për miratimin e strukturës të Institucioneve dhe Ndërmarrjeve në varësi të Bashkisë Korçë”, ka sjellë ndarje të detyrave të përgjithshme dhe specifike të organizimit të punës, marrëdhënieve ndërmjet niveleve të ndryshme hierarkike dhe paralele, duke përcaktuar dhe qartësuar më mirë kompetencat e çdo njësie të strukturës organizative, duke rritur cilësinë dhe efektivitetin e tyre me qëllim që të rritet eficientia e procedurave që realizojnë institucionin në tërësi. Kjo strukturë e re i përgjigjet më mirë zhvillimeve të reja dhe kërkesave në rritje për një territor më të zgjeruar, për një shërbim në ndihmë të komunitetit në përputhje me standartet bashkëkohore.

Objektivat e politikës së programit:

- a. Fuqizimi i kapaciteteve të burimeve njerëzore në Bashki në mënyrë që ti përgjigjen realizimit të vizionit për të ardhmen.
- b. Nxitja e sigurimit të shërbimit cilësor.
- c. Të ofroj një partneritet, koordinim dhe mirëkuptim midis palëve duke garantuar mbarëvajtje optimale të punës në shërbim të komunitetit.
- d. Mbledhja dhe përdorimi me dobi, frytshmëri dhe transparencë e fondeve publike në përputhje me programin e qeverisë dhe strategjisë kombëtare për zhvillim dhe integrim.
- e. Mbledhja e borxhit të krijuar nga 2011-2016.
- f. Rritja e numrit të bizneseve të licensuar.
- g. Përgatitja dhe miratimi në kohë i buxhetit vjetor dhe buxhetit afatmesëm.
- h. Menaxhimi i efektshëm i financave.
- i. Të kryhen auditime specifike sipas kërkesave të menaxhimit më të lartë të Institucioneve.
- j. Shlyerja në kohë e borxhit.
- k. Realizimi, informimi dhe sensibilizimi i komunitetit lidhur me projektet, investimet dhe programet e Bashkisë.
- l. Shërbim i shpejtë dhe eficient në shërbim të komunitetit në zyrat e Gjendjes Civile dhe QKB-së.

Produktet që synohen të ofrohen

- a. Plotësimi 100% me punonjës i strukturës organizative të miratuar, në bazë të politikave të përcaktuara për rekrutim, seleksionim dhe emërimin e punonjësve civile, si dhe marrjen në punë të punonjësve të tjerë .
- b. Përmirësimi i vazhdueshëm i kushteve të punës dhe shërbimit për komunitetin .
- c. Përmirësimi i produktivitetit, efektivitetit dhe efijencës së punonjësve duke zhvilluar dhe përdorur më mirë talentet dhe potencialin e tyre.
- d. Sigurimi i programeve trajnuese që punonjësit të zhvillojnë njohuritë, aftësitë për të qënë më të kualifikuar për të realizuar detyrat që bëjnë aktualisht si dhe për të ecur përpara sipas kërkesave specifike të drejtorive përkatëse duke plotësuar nevojat për trajnime .
- e. Shlyera 100% e detyrimeve si dhe vendimet gjyqësore të krijuara.
- f. Shërbime cilësore.

Aktivitetet që synohen të realizohen

- a. Realizimi i pagesës së pagave dhe të sigurimeve shoqërore për punonjësit e Bashkisë.
- b. Plotësimi i kërkesave për kushte normale të punës në administratë.
- c. Sigurimi i materialeve dhe shërbimeve speciale.
- d. Realizimi i shërbimeve ndaj të tretëve.
- e. Mirëmbajtja e mjeteve të transportit, pajisjeve të zyrave dhe ambjenteve të zyrave nëpërmjet realizimit të shpenzimeve të mirëmbajtjes së zakonshme.
- f. Realizimi i shpenzimeve për pritje percjellje.
- g. Realizimi i shpenzimeve të tjera operative.

Burimet e programit

Të ardhurat nga taksat dhe tarifata vendore, transfertat e pakushtëzuar dhe transfertat e kushtëzuar. Përdorimi i këtyre të ardhurave jepet si më poshtë:

000/lekë

Dokumenti i rishikuar i Programit Buxhetor Afatmesëm 2018-2020

Nr.	Shpenzimet	Plan 2018	Plan 2019	Plan 2020
1	Shpenzime për personelin	176,195	179,509	182,890
2	Shpenzime të tjera korrente	267,867	272,242	280,358
3	Shpenzime për investime	22,830	23,665	24,138
	Total	466,892	475,416	487,386

2. Programi mbrojtja nga zjarri dhe i emergjencave civile

Programi i mbrojtjes nga zjarri dhe emergjencave civile synon garantimin e shërbimit zjarrfikës në nivel vendor dhe administrimin e strukturave përkatëse të përcaktuara në ligj, parandalimin me masat e mbrojtjes nga zjarri si dhe ardhjen në ndihmë të dëmtuarve në raste të fatkeqësive natyrore ose fatkeqësi të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore.

Politika e programit

Politika e këtij programi konsiston në mbështjen dhe asistimin e njësisë së qeverisjes vendore, në rastet e fatkeqësive të ndryshme natyrore apo raste të dëmtimeve nga zjarri.

Njësitë shpenzuese

Bashkia Korçë dhe struktura MZSH

Objektivat e politikës së programit

- Parandalimi me masat e mbrojtjes nga zjarri, ndërhyrja në shuarjen e zjarreve, shpëtimi i jetës, gjësë së gjallë, pronës, mjedisit, pyjeve dhe kullotave në aksidente të ndryshme, fatkeqësi natyrore apo të shkaktuara nga dora e njeriut.
- Bashkia duhet të mbulojë territorin e saj me shërbimin zjarrfikës me stacione të kompletuara me personel, automjete dhe paisje zjarrfikëse.
- Përmirësimi i infrastrukturës për mbrojtjen nga zjarri (automjete, paisje, uniforma).
- Kualifikimi periodik dhe rritja e aftësive profesionale të personelit zjarrfikës.
- Evidentimin e dëmeve dhe në rastet e fatkeqësive natyrore apo fatkeqësi të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore dhe vlerësimi i tyre.

Produktet që synohen të arrihen

- Objekte, prona dhe jetë njerëzish të shpëtuar.
- Gjendja sa më shpejt e shërbimit zjarrfikës ndaj komunitetit (shërbim I shpejtë dhe me cilësi)
- Të ndihmuar financiarisht në raste fatkeqësish.

Aktivitetet që synohen të realizohen

- Bashkërendimi i punës të shërbimit zjarrfikës me forca të tjera operuese në ndihmë të komunitetit.
- Ngritja e grupeve të konstatimit për evidentimin e dëmeve.
- Bashkëpunimi edhe me institucione të tjera.
- Shqyrtimi i të gjithë dokumentacionit tekniko – ligjor në ndihmë të familjeve.
- Trajnime të personelit të shërbimit zjarrfikës.
- Paisje me mjete dhe uniforma cilësore për punonjësit e MNZSH-së.

Burimet e programit

Të ardhura nga taksat dhe tarifatat vendore dhe transfertat specifike.

Përdorimi i këtyre të ardhurave jepet si më poshtë:

000/lekë

Nr.	Shpenzimet	Plan 2018	Plan 2019	Plan 2020
1	Shpenzime për personelin	25,168	25,168	25,168

Dokumenti i rishikuar i Programit Buxhetor Afatmesëm 2018-2020

2	Shpenzime të tjera korrente	5,573	5,633	5,694
3	Shpenzime për investime	1,500	1,800	1,900
	Total	32,241	32,601	32,762

3. Programi i administrimit të pyjeve

Programi i administrimit të pyjeve synon administrimin e fondit pyjor kullor sipas legjislacionit në fuqi. Gjithashtu ky program ka për qëllim zhvillimin dhe mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave, pasuri kombëtare me rëndësi të veçanta, për vlerat e mëdha dhe të pazëvendësueshme në mbrojtjen e klimës dhe tokës.

Politika e programit

Përfaqëson synimet, prioritetet dhe drejtimet kryesore për zhvillimin afatgjatë e të qëndrueshëm të pyjeve dhe kullotave. Politika e këtij programi konsiston ruajtjen dhe përmirësimin e potencialeve prodhuese, biodiversitetit, burimeve gjenetike dhe regjimit hidrik në interes të brezave të sotëm dhe të ardhshëm.

Njësitë shpenzuese

Bashkia Korçë

Objektivat e politikës së programit

- Administrimi, qeverisja dhe mbrojtja e fondit pyjor dhe kullor kombëtar, mbi bazën e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm.
- Krijimi i marrëdhënieve midis NJQV, pronarëve dhe biznesit privat për administrimin qeverisjen dhe mbrojtjen e fondit pyjor.
- Plotësimi i nevojave me dru zjarri për popullatën.
- Arkëtimi 100% i sipërfaqeve të dhëna me qera.

Produktet që synohen të arrihen

- Pyje dhe kullota të mbrojtura
- Mbarështimi I pyjeve dhe kullotave

Aktivitetet që synohen të realizohen

- Krijimi I strukturave për mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave
- Bashkëpunimi me institucione të tjera.
- Krijimi i planeve për mbarështimin dhe përdorimin e pyjeve dhe kullotave.

Burimet e programit

Të ardhura nga taksat dhe tarifata vendore dhe transfertat specifike.

Përdorimi i këtyre të ardhurave jepet si më poshtë:

000/lekë

Nr.	Shpenzimet	Plan 2018	Plan 2019	Plan 2020
1	Shpenzime për personelin	6,107	6,107	6,107
2	Shpenzime të tjera korrente	356	356	356
3	Shpenzime për investime	11,000	12,000	12,000
	Total	17,463	18,463	18,463

4. Programi i menaxhimit rrugor dhe transporti publik

Programi i menaxhimit rrugor, transportit publik synon investime në infrastrukturën rrugore, përmirësimi i transportit publik dhe implementimin e Planit të Përgjithshëm Vendor për zhvillimin e territorit.

Një nga objektivat e Planit të Përgjithshëm Vendor është drejtimi i zhvillimit të sistemeve të banimit

e sistemeve të tjera të ndërtueshme si dhe rregullimi i ruajtjes, përdorimit dhe sipas rastit, mbarështimit të sistemeve të tjera territoriale të pandërtueshme. Pikërisht për qëllime planifikimi dhe menaxhimi të territorit, territori ndahet në sisteme territoriale, të cilat përcaktohen në nivel makroplanifikues, që në Strategjinë e Zhvillimit të Territorit, dhe detajohen përmes Planit të Zhvillimit të Territorit dhe Rregullores së PPV-së. Gjithashtu u miratua dhe strategjia territoriale pjesë e planit të përgjithshëm vendor. Propozimet territoriale të prezantuara në Strategjinë e Zhvillimit të Territorit të Bashkisë Korçë, dhe të detajuara në këtë dokument, janë reflektuar edhe në sistemet territoriale të propozuara, sipas përcaktimeve të Rregullores së Planifikimit të Territorit si më poshtë:

- Sistemi urban: formohet nga bashkimi i territoreve urbane dhe kufizohet nga vija e gjelbër.
- Sistemi natyror: përbëhet nga peizazhet, hapësirat e paprekuara të natyrës, korridoret ekologjike dhe hapësirat që kanë një kategori bazë të përdorimit “natyrë” (N) dhe në përputhje me legjislacionin e posaçëm.
- Sistemi bujqësor përbëhet nga toka bujqësore, e zënë me bimët e arave, pemishtet, vreshtat dhe ullishtat, kudo ku ndodhet dhe që ka veçori thelbësore të saj pjellorinë dhe kanalet, rezervuarët në shërbim të saj. Sistemi bujqësor formohet nga bashkimi i tokave me kategori bazë të përdorimit të tokës “bujqësinë” (B). Ky sistem është rezultat i ndërveprimit në kohë midis aktiviteteve njerëzore, për kultivim dhe ndërtime me karakter bujqësor në territor. Zonimi i sistemit bujqësor bazohet në bonitetin e tokës dhe në aktivitete e funksione që zhvillohen brenda këtij sistemi, sipas legjislacionit të posaçëm në fuqi.
- Sistemi ujqor është tërësia e burimeve nëntokësore dhe mbitokësore ujore, që përmban të gjithë trupat ujqorë, përfshirë brigjet sipas përcaktimeve të legjislacionit të posaçëm. Sistemi ujqor formohet nga rrjeti me kategori bazë të përdorimit të tokës “ujë” (U).
- Sistemi infrastrukturor përmban rrjetet kryesore të infrastrukturës, në nivel kombëtar, nivel qarku dhe vendor. Sistemi infrastrukturor formohet nga rrjeti me kategori bazë të përdorimit të tokës “infrastrukturë” (IN).

Meqënëse një nga problematikat kryesore të evidentuara gjatë hartimit të analizës së infrastrukturës ishin problematikat në qarkullim si pasojë e mungesës së një hierarkie rrugore, si p.sh. lidhje të rrugëve interurbane kryesore drejtpërdrejt me rrugë lokale, propozimet për ndërhyrje në infrastrukturën rrugore kanë të bëjnë kryesisht me ndërhyrje në rrugët ekzistuese për të konsoliduar rrjetin rrugor dhe për ta plotësuar atë me rrugë të kategorive të përshtatshme për ta bërë sa më eficient qarkullimin. Një plan i tillë duhet të realizohet për të siguruar në mënyrë të veçantë:

- Përmirësimin e kushteve të qarkullimit (lëvizjen dhe parkimet)
- Reduktimin e aksidenteve rrugore
- Reduktimin e ndotjes atmosferike dhe zhurmave
- Respektimin e vlerave ambjentale
- Zvogëlimin e shpenzimeve publike dhe private

Politika e programit

Zhvillimi i një qyteti të qëndrueshëm me cilësi të mirë jetese për banorët e tij.

Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrugëve vendore dhe sinjalizimi rrugor, i trotuareve dhe shesheve publike vendore.

Funksionimi i transportit publik urban

Njësitë shpenzuese

Bashkia Korçë

Objektivat e politikës së programit

1. Përmirësimi i kushteve urbane për të menaxhuar një zhvillim afatshkurtër dhe afatgjatë

- Rehabilitimi i infrastrukturës në zonat ku janë parashikuar zhvillime urbane.
- Rrugë me cilësi të lartë dhe zhvillim urban me hapësira të reja publike.
- Ndërtimi i terminalit të autobuzëve.

Dokumenti i rishikuar i Programit Buxhetor Afatmesëm 2018-2020

2. Menaxhimin e përmirësuar të mjedisit me anë të rritjes së kapaciteve njerëzore dhe logjistike për të minimizuar rreziqet për shëndetin.

Më poshtë po japim tabelën e prioriteteve të investimeve të miratuara me VKB nr. 2 datë 12.1.2017, për vitin 2017, 2018 dhe 2019.

Infrastruktura		
Qyteti i Korçës		
1.	Sistemim rrugë e lulishte tek blloku i banimit lagja 16	66.000.000 lek
2.	Sistemim rrugë e lulishte tek blloku i banimit lagja 8	40.000.000 lek
3.	Rikonstruksion i rrugëve ne lagjen 6	40.000.000 lek
4.	Rikonstruksion i Rrugëve dhe kanalizimit në bllok banimin e L. 18 (ish fabrika e bukës)	120.000.000 lek
5.	Rikonstruksion i rrugëve dhe kanalizimet në bllokun informal tek ish SMT-ja	44.000.000 lek
6.	Rikonstruksion i Bulevard “Gjergj Kastrioti” dhe unifikimi i fasadave përgjatë tij	100.000.000 lek
7.	Rikonstruksion i rrugës “Midhi Kostani”	25.000.000 lek
8.	Rikonstruksion i lulishtes “Vangjush Mio”	200.000.000 lek
9.	Rikonstruksioni i rrugëve tek blloku i banesave 2 dhe 3 kate Lagja 4.	14.500.000 lek
10.	Rikonstruksion rruge bllok banimi në lagjen 10	2.000.000 lek
11.	Rikonstruksioni i rrugëve në lagjen 13	43.000.000 lek
12.	Rikonstruksion i rrugëve në lagjen 5	72.000.000 lek
13.	Rikonstruksion i rrugëve në Lagjen e Re nën Mborje (L. 4)	70.000.000 lek
14.	Rikonstruksion i rrugës “Dhimitës Emanuel” (Rruga e Barçit)	23.000.000 lek
15.	Rikonstruksion i rrugës “Mitingu i shkronjave” (Bllok informal ish NB)	22.000.000 lek
16.	Rikonstruksion i rrugës “Sotir Kozmo” (Blloku informal Sporti)	22.000.000 lek
17.	Ndërtim i “Kopështit Japonez” (lulishtes tek Shetroja)	260.000.000 lek
18.	Rikonstruksion i lulishtes “Lëndina e Lotëve”	20.000.000 lek
19.	Rikonstruksioni i Lulishtes në veri të blv. “Republika”	10.000.000 lek
20.	Përmirësimi i cilësisë së banimit në L. 11 dhe L. 12 (NID)	200.000.000 lek
21.	Restaurimi i fasadave të ansamblit rreth sheshit të çezmës së Amzos dhe sheshit të Mitropolisë	100.000.000 lek
22.	Rikonstruksion i fasadave përgjatë Bulevard “Republika”	23.000.000 lek
23.	Rikonstruksion i fasadave dhe rrethimeve me mur guri dhe kangjella hekuri dekorative, përgjatë rrugës “Kongresi i Përmetit”	35.000.000 lek
24.	Rikonstruksion i fasadave të pallateve, përgjatë Blv. “Republika”, “Shën Gjergji”	1.000.000 lek
25.	Rikonstruksion i fasadave të pallateve, përgjatë rrugës “10 Korriku”	40.000.000 lek
26.	Rikonstruksion dhe termoizolim i fasadave të pallateve në blloqet e sistemuara	100.000.000 lek
27.	Punime mirëmbajtjeje në blloqet e banimit	10.000.000 lek
28.	Rigjenerimi i kurorës së gjelbër të Moravës	20.000.000 lek
29.	Rikonstruksione në territore publike dhe institucione në lidhje me përshtatshmërinë për personat me aftësi të kufizuar	500.000 lek
30.	Ndriçimi i Unazës Perëndimore	42.200.000 lek
31.	Shpronësime për investime publike	200.000.000 lek
32.	Shtesë për varreza publike	100.000.000 lek
33.	Rehabilitimi i kanaleve vaditës dhe kullues në të gjithë territorin e Bashkisë	65.000.000 lek

Dokumenti i rishikuar i Programit Buxhetor Afatmesëm 2018-2020

Njësia Administrative Bulgarec	
1. Sistemim – asfaltim rrugëve brenda fshati Bulgarec dhe kanalizime të ujërave të zeza nën segmentin që do të asfaltohen	120.000.000 lek
2. Sistemim – asfaltim rruga hyrëse në fshatin Porodinë deri te shkolla e fshatit	60.000.000 lek
3. Sistemim – asfaltim pjesor rruga hyrëse në fshatin Malavec	26.000.000 lek
4. Sistemim – asfaltim pjesor rruga hyrëse fshati Barç	40.000.000 lek
5. Sistemim – asfaltim pjesor rruga fshati Lumalas deri te gurorja	35.000.000 lek
6. Sistemim – asfaltim rruga e kopshtit fshati Dishnicë	16.000.000 lek
7. Sistemim – asfaltim rruga e Çobankave fshati Dishnicë	8.000.000 lek
8. Sistemim – asfaltim rrugëve në fshatin Çiflig	30.000.000 lek
9. Sistemim – asfaltim i rrugës unazë – Lumalas	50.000.000 lek
10. Sistemim – asfaltim i rrugës unazë – Belorta	20.000.000 lek
11. Sistemim – asfaltim rruga Melçan – Porodinë	70.000.000 lek
12. Sistemim – asfaltim rruga e varreve fshati Shamoll	35.000.000 lek
13. Sistemim – asfaltim rruga e varreve fshati Malavec	25.000.000 lek
14. Sistemim – asfaltim rruga e varreve fshati Çiflig	10.000.000 lek
15. Rehabilitim kanali kullues tek Kisha në Çiflig	900.000 lek
16. Sistemim – betonim kanali (jazi mullirit) fshati Bulgarec	200.000 lek
17. Kanalizimet e ujërave të zeza në të gjithë njësinë	130.000.000 lek
18. Rehabilitimi i pjesshëm i ujësjellësit të fshatit Porodinë	20.000.000 lek
19. Ndriçimi i rrugëve hyrëse dhe rrugëve të brendshme të fshtrave	200.000.000 lek
20. Projekti i furnizimit me uje fshati Shamoll	22.600.000 leke
21. Rikonstruksioni i rrugës për në teqenë e Melçanit	12.000.000 lek
22. Spostimi i kanalit të ujrave të zeza në afërsi të Depos së Ujit të fshatit Bulgarec	300.000 lek
23. Rikonstruksioni i rrugës së varrezave në Lumalas	15.000.000 lek
24. Rikonstruksioni i rrugës Dishnicë - Shamoll	12.000.000 lek
25. Rikonstruksioni i rrugës së varrezave në Belorta	30.000.000 lek
26. Rikonstruksioni i urave mbi përrenjtë në Njësinë Administrative Bulgarec	5.000.000 lek
Njësia Administrative Drenovë	
1. Sistemim – asfaltim i rrugëve të brendshme të fshatit Moravë	
2. Sistemim – asfaltim i rrugës Korçë - Drenovë	95.000.000 lek
3. Sistemim – asfaltim i rrugës nga burgu i Drenovës deri në fshatin Boboshticë	140.000.000 lek
4. Sistemim – asfaltim i rrugëve të brendshme dhe shtrim me pllaka i trotuareve në fshatin Qatrom	250.000.000 lek
5. Sistemim – asfaltim i rrugëve të brendshme të fshatit Mborje	60.000.000 lek
6. Sistemim – asfaltim i rrugëve të brendshme të fshatit Ravonik	30.000.000 lek
7. Shtrim me kalldrëm i disa rrugëve në fshatin Dardhë	100.000.000 lek
8. Rigjenerimi i Parkut Kombëtar “Bredhi i Drenovës”	50.000.000 lek
9. Shtrimi i rrjetit të kanalizimeve të ujërave të zeza në fshatrat Moravë, Drenovë, Turan	60.000.000 lek
10. Sistemim i rrugëve fshati Boboshtice	20.000.000 lek
11. Ndërtimi i rrjetit kanalizimeve të Burgut Drenovë	6.000.000 lek
12. Rikonstruksioni i rrugës Moravë Bozdovec	65.000.000 lek
1. Rikonstruksion i rrugës Drenovë – Minierë (Fusha e Parë) me vlerë	32.000.000 lek

Dokumenti i rishikuar i Programit Buxhetor Afatmesëm 2018-2020

Njësia Administrative Voskop	
1. Sistemim i unazës Korrcë - Polenë - Voskop- Korcë	145.000.000 lek
2. Sistemim i rrugës kryesore të fshatit Damjanec	50.000.000 lek
3. Ndërtimi i dy urave lidhëse në fshatin Vinçan	40.000.000 lek
4. Ndërtimi i urës në lumin Dunavec, në fshatin Voskop	20.000.000 lek
5. Ndërtimi i urës në lumin Dunavec, në fshatin Dërsnik	20.000.000 lek
6. Pastrimi i lumit anës fshatit Voskop dhe Goskovë Poshtë	750.000 lek
7. Shtrimi i rrjetit të ujësjellësit në një pjesë të fshatit Dërsnik	15.000.000 lek
8. Sistemimi i ujërave të zeza të fshatrave Voskop, Dërsnik, Polenë, Goskovë Poshtë, Goskovë Lart, Vinçan dhe Damjanec	70.000.000 lek
Njësia Administrative Voskopojë	
